

Prishtinë, 28 maj 2009
Kodi i ZRRE-së: V_175_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e nenit 4 të Licencës për shpërndarje të ngrohjes qendrore dhënë N.Q. "Termokos" SH.A.;
3. Kërkesën e N.Q. "Termokos" SH.A për miratimin e Kodit të Matjes;

në seancën e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET Kodi i Matjes i NQ Termokos SH.A.

1. Bazuar në përgjegjësitë që dalin nga neni 4.1 i Licencës së Shpërndarjes së ngrohjes qendrore dhënë NQ Termokos SH.A, i licencuari obligohet që të përgatisë Kodin e matjes dhe këtë ta dërgojë në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për aprovim.
2. ZRRE ka pranuar kërkesën e të licencuarit - NQ Termokos SH.A. për miratim të Kodit të matjes, përmes postës së rregullt dhe postës elektronike.
3. Gjatë analizimit ZRRE ka vlerësuar se Kodi përmban dispozita të cilat vendosin bazën për matjen komerciale të energjisë termike në tregun e ngrohjes qendrore dhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve për sa i përket matjes së energjisë termike për ngrohje.
4. Në përputhje me nenin 4.3 të Licencës së shpërndarjes së ngrohjes qendrore, i licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Kod në faqen e tij elektronike zyrtare.
5. Vendimi lëshohet në gjuhën shqipe dhe përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis përkthimeve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Vendimi hyn në fuqi në datën e nxjerrjes së tij, kur edhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda 14 ditësh nga data e hyrjes së vendimit në fuqi.

Bashkëngjitur në këtë vendim është Kodi i Matjes i NQ Termokos.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar